

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

HASAN PRISHTINA

FAKULTETI JURIDIK



STUDIME POSTDIPLOMIKE

MASTER KUSHTETUES - ADMINISTRATIV

Tema:

Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuar dhe sfidat për qasje në drejtësi

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Flamur Hyseni

Studenti:

Rrezarta Ukaj

Prishtinë, 2023

ABSTRAKTI

Personat me aftësi të kufizuara, “pakica më e madhe në botë”, shpesh përballen me pengesa për pjesëmarrje në të gjitha aspektet e shoqërisë. Pengesat mund të marrin forma të ndryshme, duke përfshirë ato që lidhen me mjedisin fizik apo me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, ose ato që rrjedhin nga legjislacioni apo politika, apo nga qëndrimet ose diskriminimi shoqëror.

Rezultati është se personat me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje të barabartë në shoqëri ose shërbime, duke përfshirë arsimin, punësimin, kujdesin shëndetësor, transportin, pjesëmarrjen në politikë. Përvoja tregon se kur pengesat për përfshirjen e tyre janë larguar dhe personat me aftësi të kufizuara janë lejuar të marrin pjesë plotësisht në jetën shoqërore, përfitimet e tyre dhe të gjithë komunitetit janë rritur. Shpenzimet për aftësinë e kufizuar, qoftë në para apo në shërbime dhe kushtet në të cilat ndodhet ekonomia sot, po bëjnë që kalimi nga skemat pasive në ato aktive, ku personat me aftësi të kufizuar janë taksapagues dhe kontribues në shoqëri, të kalojë në plan të parë të politikave mbi çështjet e aftësisë së kufizuar.

Edhe pse kemi një kuadër ligjor me parashikime të caktuara për personat me aftësi të kufizuara, ai është i paplotë dhe i pamjaftueshëm dhe njëkohësisht nuk mund të gjejë zbatim, pasi ka mangësi të theksuara në zinxhirin e tregut të punës. Mungesa e parashikimeve dhe procedurave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara gjatë rekrutimit ka ndikimin e saj negativ në mundësitë për akses të tyre në vendet e punës.

Sigurisht, që për zbatimin e “përshtatjes së arsyeshme” do të duhet një interpretim shumë i saktë i këtij koncepti nga institucionet të cilat do të kenë detyrën për zbatimin apo monitorimin e aplikimit të saj. Sidomos, rol të veçantë do të ketë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo gjykatat dhe të gjithë aktorët përgjegjës për zbatimin e ligjit.

Mungesa e të dhënave statistikore është një nga sfidat dhe pengesat më të mëdha në hartimin dhe zbatimin e politikave efektive në favor të Personave me Aftësi të Kufizuar në vendin tonë. Me qëllim të planifikimit të mirëfilltë të strategjive, politikave, shërbimeve dhe shpërndarjes së resurseve është qenësore ekzistimi i të dhënave dhe hulumtimeve mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet dhe natyrën e aftësive të kufizuara, nevojat dhe gjendjen e tyre ekonomiko-sociale e shëndetësore.

